



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

PLANI I SIGURIMIT DHE KOORDINIMIT NË PUNË.

Objekti i Kontratës: “Zgjidhja E Nyjes Hidraulike në Kanalin e Naumkës, në Segmentin e Kalimit të Rrugës dhe Linjës Hekurudhore, në Funkcion të Përmirësimit të Kullimit dhe Shkarkimit Drejt Hidrovorit”

AUTORITETI KONTRAKTOR
" BASHKIA VLORE"

OPERATORI EKONOMIK
"DERBI-E" Sh.p.k



DERBI-E STUDIO

Përmbajtja

Përmbajtja	2
1. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT TË PLANIT	3
2. BAZA LIGJORE DHE NORMATIVE	3
3. PËRSHKRIMI I PUNIMEVE DHE FAZAT	3
4. ORGANIZIMI I KANTIERIT	4
5. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PËRGJEGJËSITË	5
6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE	5
6.1 Regjistri i rreziqeve dhe masat parandaluese	6
7. MASAT SPECIFIKE PËR RREZIQET KRYESORE	7
7.1 Punimet brenda zonës hekurudhore	7
7.2 Gërmimi në prani uji	8
7.3 Qarkullimi rrugor dhe devijimi	8
7.4 Rrjetet nëntokësore ekzistuese	8
8. PAJISJET MBROJTËSE INDIVIDUALE (PMI)	8
9. KOORDINIMI DHE MENAXHIMI I INTERFERENCAVE	8
9.1 Rregullat e përhershme të koordinimit	9
10. PLANI I EMERGJENCËS	10
11. TRAJNIMET, INFORMIMI DHE KONTROLLI	10
12. HIGJIENA, SHËRBIMET DHE MJEDISI	11
13. KOSTOT E SIGURISË	11
14. PËRDITËSIMI I PLANIT	12
ANEKS A – LISTA E KONTROLLIT PËR INSPEKTIMIN DITOR	12

1. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT TË PLANIT

Ky Plan Sigurimi dhe Koordinimi (PSK) hartohet si pjesë përbërëse e projekt-zbatimit dhe përcakton masat organizative e teknike për parandalimin e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale gjatë realizimit të punimeve të njes hydraulike në kanalin e Naumkës.

Kantieri paraqet një kombinim rreziqesh të larta dhe të njëkohshme: gjermim i thellë në prani uji, punime nën një linjë hekurudhore aktive, punime nën një rrugë me qarkullim, ndërhyrje mbi një kanal kullues me rrjedhje të vazhdueshme dhe përdorim i mjeteve të rënda në hapësirë të ngushtë. Për këtë arsye, plani trajton në mënyrë të veçantë koordinimin ndërmjet subjekteve që veprojnë njëkohësisht në kantier dhe menaxhimin e interferencave.

PSK-ja është e detyrueshme për sipërmarrësin, nënkontraktorët, punonjësit e vetëpunësuar, furnitorët dhe çdo vizitor në kantier. Asnjë punim nuk mund të fillojë përpara pranimit me shkrim të këtij plani nga sipërmarrësi dhe përpara hartimit të Planit Operativ të Sigurisë (POS) nga ana e tij.

2. BAZA LIGJORE DHE NORMATIVE

- Ligji nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”;
- VKM nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”;
- VKM nr. 107, datë 09.02.2011 “Për përcaktimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”;
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe aktet nënligjore për sinjalistikën e sigurisë;
- Ligji nr. 142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe rregulloret e brendshme të operatorit hekurudhor për punimet brenda zonës së mbrojtur hekurudhore;
- Rregullat e qarkullimit rrugor dhe aktet për sinjalizimin e përkohshëm të punimeve në rrugë;
- Eurokodi 7 (EN 1997) për stabilitetin e gjurmëve dhe të mbështetjeve të përkohshme.

3. PËRSHKRIMI I PUNIMEVE DHE FAZAT

Punimet konsistojnë në ndërtimin e një tombinoje monolite betonarme me dy qeliza 2.00×2.00 m nën rrugë dhe nën linjën hekurudhore, me gjermim rreth 408 m³ në thellësi deri ≈ 3.2 m, betonim 166 m³, armim 19 ton, si dhe çmontim e rikthim të një segmenti hekurudhor prej 11.3 ml. Fazat e punës dhe rreziqet mbizotëruese janë:

Faza	Punimet	Rreziku mbizotërues
F0	Organizimi i kantierit, rrethimi, trajnimet	Trafik rrugor
F1	Devijim i ujërave dhe pompim i vazhduar	Vërshim, mbytyje, elektrik
F2	Prerje asfalti, çmontim binari, heqje ballasti	Trafik hekurudhor
F3	Gjermim, prishje strukturash, transport	Shembje faqesh, mjete të rënda
F4	Themeli: çakëll, gjeotekstil, magrone	Punë në gropë
F5	Armim, kallëpim, betonim (3 kampata)	Ngarkesa të varura, rënie
F6	Hidroizolim, drenazh, mbushje anësore	Kimikate, ngjeshje
F7	Rikthim i rrugës dhe i linjës hekurudhore	Trafik hekurudhor dhe rrugor
F8	Sistemim, pastrim, kolaudim	Rrëshqitje, mbeturina

4. ORGANIZIMI I KANTIERIT

Kantieri organizohet në zona funksionale të ndara qartë, me qarkullim të njëanshëm të mjeteve dhe me shtigje të veçanta e të mbrojtura për këmbësorët. Zona e punimeve rrethohet plotësisht dhe pajiset me sinjalistikë e ndriçim.

Figura 1 - Skema e organizimit të kantierit dhe e zonave funksionale




Figura 1 – Skema e organizimit të kantierit: zonat funksionale, hyrjet, brezi i sigurisë hekurudhore dhe itinerari i devijimit.

Zona	Kërkesat e sigurisë
Zona e punimeve / gropa	Rrethim i ngurtë $h \geq 2.0$ m, parrakë mbrojtëse në buzë, shkallë ose rampa hyrëse çdo 25 m, ndriçim natën, ndalim aksesit për të pa-autorizuarit
Brez i hekurudhor	Kufizim fizik në distancë ≥ 3.0 m nga aksi i shinës; hyrje vetëm me leje pune dhe në prani të rojës sinjalizuese
Baza e kantierit	Kabina zyre, dhomë ndihme të parë, tualete kimike, ujë i pijshëm, dollap veshjesh, tabela e sigurisë
Magazinimi i shinave dhe traversave	Sipërfaqe e sheshtë dhe e ngjeshur, stivim i sigurt me pyka anësore, lartësi maksimale e stivës 1.5 m
Zona e betonit	Rrugë manovrimi për autobetoniere, zonë larjeje me pusët dekantimi, ndalim qëndrimi nën shpërndarësin e pompës
Depozitimi i dheut	Në distancë ≥ 2.0 m nga buza e gropës, me lartësi stive maksimum 2.0 m
Pika e grumbullimit	E sinjalizuar, jashtë zonës së rrezikut, e arritshme brenda 60 sekondash nga çdo pikë e kantierit
Zona e mbetjeve	Kontejnerë të ndarë; mbetjet me bitum dhe vajrat trajtohen si mbetje të rrezikshme

5. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PËRGJEGJËSITË

Figura 2 - Organigrama e sigurisë dhe zinxhiri i përgjegjësi




Figura 2 – Organigrama e sigurisë: zinxhiri hierarkik dhe marrëdhëniet e koordinimit me operatorin hekurudhor.

Roli	Detyrat kryesore
Autoriteti Kontraktor	Emëron koordinatorin e sigurisë, siguron zbatimin e PSK-së, miraton ndryshimet thelbësore
Koordinatori i sigurisë në zbatim	Verifikon zbatimin e PSK-së dhe të POS-it, organizon takimet koordinuese, ndalon punimet në rast rreziku të rëndë e të menjëhershëm, përditëson planin
Drejtuesi teknik i kantierit	Zbaton masat, organizon punën sipas fazave, siguron leje pune, mban kontaktet me operatorin hekurudhor
Përgjegjësi i sigurisë	Inspektime ditore, kontroll i PMI-ve dhe i pajisjeve, mban Regjistrin e Sigurisë, trajnimet hyrëse
Kryepunëtorët	Mbikëqyrin ekipet, ndalojnë veprimet e pasigurta, raportojnë menjëherë çdo ngjarje ose rrezik
Punonjësit	Përdorin PMI-të, respektojnë procedurat, nuk hyjnë në zona të ndaluara, raportojnë kushtet e pasigurta
Operatori hekurudhor	Jep lejen e punës dhe dritaret e bllokimit, vë në dispozicion rojën sinjalizuese, verifikon rikthimin e linjës

6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE

Vlerësimi kryhet me metodën matricore $R = P \times S$, ku P është gjasa e ndodhjes ($1 \div 5$) dhe S ashpërsia e pasojës ($1 \div 5$). Rreziqet me indeks $R \geq 13$ konsiderohen të papranueshme dhe kërkojnë masa parandaluese përpara fillimit të punimeve; rreziqet me $R = 9 \div 12$ kërkojnë masa të planifikuara dhe kontroll të vazhdueshëm.

Figura 3 - Matrica e vlerësimit të rrezikut (P × S) dhe pozicionimi i rreziqeve para masave




Figura 3 – Matrica e vlerësimit të rrezikut dhe pozicionimi i rreziqeve të identifikuara para zbatimit të masave.

6.1 Regjistri i rreziqeve dhe masat parandaluese

Nr.	Rreziku	P	S	R	Masat parandaluese kryesore
R1	Përplasje me tren / punime pranë linjës aktive	3	5	15	Punime vetëm brenda dritareve të miratuara të bllokimit; leje pune me shkrim; rojë sinjalizuese me lidhje radio; kufizim fizik i brezit 3.0 m; ndalim absolut i kalimit mbi shina jashtë pikave të caktuara
R2	Shembje e faqeve të gropës së gërmimit	3	5	15	Mbështetje me palanka/kaseta metalike ose pjerrësi e sigurt sipas raportit gjeoteknik; ndalim depozitimi ngarkesash brenda 2.0 m nga buza; inspektim ditor i faqeve pas çdo reshjeje
R3	Vërshim i papritur dhe mbytje në gropë	2	5	10	Devijim i garantuar i rrjedhës me by-pass; pompim rezervë (pompë e dytë me gjenerator); monitorim i parashikimit të motit; procedurë evakuimi brenda 5 minutash; jelekë shpëtimi pranë ujit
R4	Rrëzim personash në gropë	3	4	12	Parmakë h = 1.0 m me dorezë të ndërmjetme dhe bordurë këmbë; shkallë të fiksuara; ndriçim; ndalim kërcimi mbi gropë
R5	Goditje nga mjete të rënda dhe ekskavator	4	3	12	Ndarje fizike e shtigjeve këmbësore; ndalim qëndrimi në rrezen e veprimit të krahut; sinjalist gjatë manovrave prapa; alarm marshimi prapa i funksionshëm
R6	Rënie e ngarkesave të varura (armaturë, kallëpe, shina)	3	4	12	Vinç dhe pajisje ngritëse me certifikatë të vlefshme; kontroll i litarëve para çdo turni; zonë e ndaluar nën ngarkesë; manovra me sinjalist të vetëm
R7	Goditje elektrike (pompa, gjeneratorë, kablllo)	2	4	8	Kuadro elektrike me diferencial 30 mA dhe tokëzim; kablllo të ngritura ose të mbrojtura; pajisje IP të përshtatshme për punë me ujë; ndalim ndërhyrjesh nga persona të pakualifikuar

Nr.	Rreziku	P	S	R	Masat parandaluese kryesore
R8	Pluhur, zhurmë dhe dridhje	4	2	8	Lagje e sipërfaqeve gjatë prerjes dhe transportit; maska FFP2; mbrojtëse dëgjimi; rotacion i punonjësve në punimet me çekiq hidraulik
R9	Rënie objektësh nga niveli i sipërm	3	3	9	Helmetë e detyrueshme; bordurë këmbë në buzë; ndalim depozitimi i veglave në buzë; rrjeta mbrojtëse ku është e nevojshme
R10	Shembje kallëpesh gjatë betonimit	2	3	6	Kallëpe të llogaritura dhe të kontrolluara para betonimit; shpejtësi e kontrolluar e derdhjes; ndalim qëndrimi nën pllakën në betonim
R11	Aksident me trafikun rrugor	4	2	8	Devijim i sinjalizuar me tabela dhe konusë; jelekë me shirita reflektues; kufizim shpejtësie 20 km/h; ndriçim natën; rojë trafiku në hyrje-dalje
R12	Saldim, prerje me disk, zjarr	2	4	8	Leje pune me flakë; fikëse zjarri pranë vendit të punës; ekran mbrojtës; largim i materialeve të djegshme; mbikëqyrje 30 min pas përfundimit

Pas zbatimit të masave, asnjë rrezik nuk qëndron mbi pragu të pranueshmërisë ($R = 12$); rreziqet R1, R2 dhe R5 mbeten nën vëzhgim të përhershëm nga koordinatori i sigurisë.




Figura 4 – Krahasimi ndërmjet rrezikut fillestar dhe rrezikut mbetës pas zbatimit të masave parandaluese.

7. MASAT SPECIFIKE PËR RREZIQET KRYESORE

7.1 Punimet brenda zonës hekurudhore

- punimet kryhen vetëm pas marrjes së lejes me shkrim nga operatori hekurudhor dhe brenda dritareve kohore të miratuara të bllokimit të qarkullimit;
- në kantier qëndron gjithnjë një rojë sinjalizuese e pajisur me radio, bori dhe flamur, e cila ka autoritet të ndalojë menjëherë punimet;
- vendoset kufizim fizik dhe sinjalistikë e brezit të sigurisë 3.0 m nga aksi i shinës më të afërt;
- ndalohet çdo depozitim materialesh ose vegla brenda gabaritit hekurudhor;
- mjetet e larta (ekskavator, vinç) punojnë me krah të kufizuar mekanikisht kur ndodhen pranë linjës;

- pas rikthimit të linjës, gjeometria verifikohet dhe pranohet nga operatori hekurudhor përpara rikthimit të qarkullimit.

7.2 Gërmimi në prani uji

- gërmimi kryhet me faqe të mbështetura ose me pjerrësi të sigurt, sipas kushteve të truallit të përcaktuara në raportin gjeoteknik;
- pompimi është i vazhdueshëm (24/7) me pompë rezervë dhe gjenerator emergjence;
- niveli i ujit brenda gropës matet dhe regjistrohet dy herë në ditë;
- ndalohet hyrja në gropë kur niveli i ujit tejkalon 0.30 m ose kur ka reshje të forta në zhvillim;
- sigurohen dy dalje të pavarura nga gropa dhe ruhet një jelek shpëtimi me litar pranë çdo daljeje.

7.3 Qarkullimi rrugor dhe devijimi

- devijimi hartohet dhe sinjalizohet paraprakisht, me tabela paralajmëruese në distancë të mjaftueshme nga kantieri;
- gjatë orëve me qarkullim intensiv sigurohet rojë trafiku;
- gropat dhe pengesat mbulohen ose rrethohen dhe pajisen me llamba sinjalizuese natën;
- hyrja dhe dalja e mjeteve të rënda bëhet vetëm nën drejtimin e sinjalistit.

7.4 Rrjetet nëntokësore ekzistuese

Përpara gërmimit kryhet identifikimi i tubacioneve dhe i kablllove të evidentuara në rilevimin topografik (tubacione, shkarkime, shtylla elektrike dhe IT). Gërmimi në afërsi të tyre kryhet me krah, pas verifikimit me operatorët përkatës dhe pas ndërprerjes së shërbimit kur është e nevojshme.

8. PAJISJET MBROJTËSE INDIVIDUALE (PMI)

Pajisja	Standardi / kërkesa	Përdorimi i detyrueshëm
Helmetë mbrojtëse	EN 397, me rrip nënmjekror	Gjithnjë, në të gjithë kantierin
Këpucë sigurie	EN ISO 20345 S3, me thembër dhe shollë antipërshkuese	Gjithnjë; çizme gome S5 në gropë me ujë
Jelek me shirita reflektues	EN ISO 20471, klasa 3 (portokalli/verdhë)	Gjithnjë; klasa 3 e detyrueshme pranë hekurudhës dhe rrugës
Doreza pune	EN 388 (mekanike), EN 374 për punime me bitum	Gjatë armimit, kallëpimit, hidroizolimit
Syze mbrojtëse / maskë fytyre	EN 166	Prerje asfalti, saldim, çekiq hidraulik
Mbrojtëse dëgjimi	EN 352	Kur zhurma tejkalon 85 dB(A)
Maskë respiratore FFP2/FFP3	EN 149	Punime me pluhur silici, prerje betoni
Brez sigurie / linjë jete	EN 361 + EN 355	Punime në buzë të gropës pa parmakë të plotë
Jelek shpëtimi	EN ISO 12402	Punime pranë ujit të rrjedhshëm ose në gropë të përmytur

PMI-të jepen falas nga sipërmarrësi, regjistrohen në fletën e dorëzimit të nënshkruar nga punonjësi dhe zëvendësohen menjëherë kur dëmtohen.

9. KOORDINIMI DHE MENAXHIMI I INTERFERENCAVE

Interferenca është prania e njëkohshme e dy ose më shumë aktiviteteve që rrisin rrezikun reciprok. Në këtë kantier identifikohen dy dritare kritike interference, të cilat kërkojnë planifikim të posaçëm dhe prani të detyrueshme të koordinatorit të sigurisë.




Figura 5 – Grafiku i fazave dhe dritareve kritike të interferencës që kërkojnë koordinim të posaçëm.

Dritarja	Aktivitetet e njëkohshme	Rregulli i koordinimit
Ditët 8 ÷ 14	Çmontim hekurudhor + prerje asfalti + fillim gërmimi	Ndalohet gërmimi me ekskavator njëkohësisht me punimet mbi shina; sekuencë e detyruar dhe takim koordinues në fillim të çdo turni
Ditët 39 ÷ 47	Rikthim i trupit rrugor + rikthim i linjës hekurudhore + provat	Ndarje e zonave të punës me barriera; asnjë mjet i rëndë nuk lëviz gjatë vendosjes së shinave
E vazhdueshme (ditët 4 ÷ 36)	Pompimi dhe devijimi i ujërave gjatë të gjitha fazave	Kontroll ditor i pompave; asnjë ndërprerje pa miratimin e drejtuesit teknik

9.1 Rregullat e përhershme të koordinimit

- takim koordinues javor me pjesëmarrjen e sipërmarrësit, nënkontraktorëve dhe koordinatorit të sigurisë, me procesverbal;
- takim i shkurtër (5 minuta) në fillim të çdo turni për rreziqet e ditës;
- çdo nënkontraktor dorëzon POS-in e vet të përputhur me këtë PSK përpara hyrjes në kantier;
- ndryshimet e sekuencës së punimeve miratohen paraprakisht nga koordinatori i sigurisë;
- të gjitha lejet e punës (hekurudhë, punë me flakë, punë në hapësira të kufizuara) lëshohen me shkrim dhe arkivohen.

10. PLANI I EMERGJENCËS

Figura 7 - Skema e procedurës së emergjencës dhe e njoftimit




Figura 7 – Skema e procedurës së emergjencës dhe e zinxhirit të njoftimit.

Kontakti	Numri / përgjegjësi
Numri unik i emergjencës	112
Ambulanca / urgjenca mjekësore	127
Zjarrfikësja	128
Policia	129
Drejtuesi teknik i kantierit	(plotësohet para fillimit të punimeve)
Koordinatori i sigurisë	(plotësohet para fillimit të punimeve)
Operatori hekurudhor – dispeçeri	(plotësohet para fillimit të punimeve)
Bashkia Vlorë – mbikëqyrja e punimeve	033 421 225

Në kantier mbahen: kuti e plotë e ndihmës së parë, të paktën dy punonjës të trajnuar për ndihmën e parë në çdo turn, fikëse zjarri pranë zonës së saldimit dhe të karburanteve, si dhe një mjet i disponueshëm për transport urgjent. Ushtrimi i evakuimit kryhet një herë gjatë zbatimit të punimeve dhe regjistrohet.

Tabela me numrat e emergjencës, skema e kantierit dhe pika e grumbullimit afishohen në hyrje të kantierit dhe në kabinën e zyrës.

11. TRAJNIMET, INFORMIMI DHE KONTROLLI

Aktiviteti	Frekuenca	Përgjegjësi dhe dokumentimi
Trajnim hyrës (induksion) për çdo punonjës të ri	Para hyrjes së parë	Përgjegjësi i sigurisë – fletë prezence e nënshkruar
Takim i shkurtër për rreziqet e ditës	Çdo turn	Kryepunëtori – regjistër i shkurtër

Aktiviteti	Frekuenca	Përgjegjësi dhe dokumentimi
Takim koordinues me nënkontraktorët	Javore	Koordinatori i sigurisë – procesverbal
Inspektim i kantierit (lista e kontrollit)	Ditore	Përgjegjësi i sigurisë – Regjistri i Sigurisë
Kontroll i pajisjeve ngritëse dhe elektrike	Javore	Drejtuari teknik – fletë kontrolli
Verifikim i faqeve të gërmimit	Ditore dhe pas çdo reshjeje	Kryepunëtori i gërmimit
Vizita mjekësore e punonjësve	Para fillimit të punës	Sipërmarrësi – certifikata mjekësore
Ushtrim evakuimi	Një herë gjatë zbatimit	Koordinatori i sigurisë – procesverbal

Në kantier mbahen të përditësuara: Regjistri i Sigurisë, regjistri i trajnimeve, regjistri i PMI-ve të dorëzuara, lejet e punës, certifikatat e mjeteve dhe procesverbalet e takimeve koordinuese.

12. HIGJIENA, SHËRBIMET DHE MJEDISI

- kabina zyre e ngrohur/ftohur, dhomë ndërimi rrobash dhe tualet kimik me mirëmbajtje javore;
- ujë i pijshëm i garantuar dhe zonë e mbrojtur për pushimin e punonjësve;
- kufizim i punimeve me zhurmë brenda orareve të lejuara, duke pasur parasysh banesat përreth;
- lagje e rrugëve dhe e materialeve për kontrollin e pluhurit;
- ujërat e pompuara shkarkohen pas dekantimit, për të shmangur ndotjen e trupit ujor pritës;
- menaxhim i diferencuar i mbetjeve; vajrat, bitumi dhe filtrat trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe dorëzohen te operatorë të licencuar;
- ndalohet larja e autobetonierave jashtë zonës së caktuar me pusët dekantimi.

13. KOSTOT E SIGURISË

Kostot e sigurisë llogariten si zë më vete dhe nuk i nënshtrohen uljes së ofertës. i justifikuar nga prania e njëkohshme e rrezikut hekurudhor, rrugor dhe hidraulik.

Figura 6 - Struktura e kostove të sigurisë (shpenzime jo të nënshtruara uljes së ofertës)




Figura 6 – Struktura e kostove të sigurisë sipas zërave kryesorë.

Zëri i kostos së sigurisë	Pesha
Mbështetje e faqeve të gropës, parmakë, pasarella	24%
Rrethim, sinjalistikë dhe ndriçim i kantierit	22%
Devijim i qarkullimit, konusë, rojë trafiku	18%
PMI dhe pajisje mbrojtëse individuale	12%
Rojë sinjalizuese hekurudhore, leje dhe koordinim	12%
Trajnime, vizita mjekësore, dokumentacion	7%
Ndihma e parë dhe pajisje emergjence	5%
TOTALI	100 %

14. PËRDITËSIMI I PLANIT

PSK-ja përditësohet detyrimisht kur: ndryshon sekuenca ose teknologjia e punimeve; hyn në kantier një nënkontraktor i ri; ndodh një aksident ose një ngjarje pa pasoja (near miss); ndryshojnë kushtet hidrologjike ose gjeoteknike të konstatuara në terren; ose kur operatori hekurudhor vendos kushte të reja. Çdo rishikim numërohet, datohet dhe u komunikohet të gjithë subjekteve në kantier.

Konstatimet teknike të ngritura në Relacionin Teknik – veçanërisht mungesa në preventiv e zërave për pompimin, devijimin e përkohshëm të qarkullimit dhe sinjalistikën – duhet të zgjidhen përpara nisjes së punimeve, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me masat e këtij plani.

ANEKS A – LISTA E KONTROLLIT PËR INSPEKTIMIN DITOR

Nr.	Pika e kontrollit	Në rregull / Jo
1	Rrethimi, tabelat dhe ndriçimi janë të plota dhe të padëmtuara	
2	Brezi i sigurisë hekurudhore është i shënuar dhe i respektuar	
3	Leja e punës për punimet e ditës është e vlefshme dhe e afishuar	
4	Faqet e gërmimit dhe mbështetjet janë inspektuar dhe të sigurta	
5	Niveli i ujit në gropë dhe funksionimi i pompave janë kontrolluar	
6	Parmakët, bordurat dhe daljet nga gropa janë në vend	
7	Të gjithë punonjësit mbajnë PMI-të e kërkuara	
8	Pajisjet ngritëse dhe litarët janë kontrolluar para përdorimit	
9	Kuadri elektrik, diferenciali dhe tokëzimi funksionojnë	
10	Devijimi i qarkullimit dhe sinjalistika rrugore janë të plota	
11	Kutia e ndihmës së parë dhe fikëset e zjarrit janë të plota	
12	Zona e grumbullimit dhe rrugët e evakuimit janë të lira	

Data: _____ Inspektoi: _____ Nënshkrimi: _____

HARTOI – KOORDINATORI I SIGURISË
“DERBI-E” sh.p.k.
Ing. Bexhet Dedja